

REPUBLIKË E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO Agjensia Kunder Korrupsionit ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. Prot 03-3290/11	Data 22.09.2011

Nr.regj:29573/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Flutura Hoxha, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 par.1 i sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 29.06.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA Flutura Islam Hoxha ,e lindur me 23.08.1973 ne Gjakove,me vendbanim ne Prishtine rr."Pjeter Bogdani"pn,e pa martuar , me profesion juriste, jeton ne gjendje te mesme ekonomike,dhe deri me tani e pa denuar.

E s h t e p e r g j e g j e s e

Sepse si zyrtare e larte ne Ministrine e Administrimit te Pushtetit Lokal,Udheheqese e Divizionit per zhvillim te legjislacionit ne Departamentin Ligjor ne MAPL, nuk e ka bere deklarimin e pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit,me rastin e marrjes se detyres, ne afatin e caktuar ligjor

Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 7 par 1 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

. G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilën gjobë është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518.Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave –banke,permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata .Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 13 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur,kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €,ne sherbimin e arkes se gjykates.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

- Agjensia Kunder Korrupsionit,Prishtine parashtrroi kërkesën me nr.01/3267/10 më dt. 29.09.2010 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ne baze te kerkeses se parashtruar u inicua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehuren ,e cila deklaroi se ,kerkesa e Agjensise Kunder Korrupsion nuk i eshte dorezuar personalisht, deri sa e njejta ka pranuar nje shkrese prej Agjensionit Kunder Korrupsionit me te cilen eshte njoftuar se ndaj saj eshte inicuar procedura kundervajtese.

Ne baze te te dhenave ne kerkesese,deklarates se te pandehures, shiqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, Gjykata konstatoi se e

Me rastin e shqiptimit te denimit ,konform nenit 7 te LMK,se ,u moren parasysh te gjitha rrethanat e kryerjes se kundervajtjes,dhe te pandehures iu shqiptua denimi me gjobe ne lartesine si ne dispozitiv ,duke konsideruar se edhe me kete do te arrihet efekti i sanksionimit ,ashu qe e pandehura ne te ardhmen tu shmanget kryerjes se veprave te tilla apo te ngjashme kundervajtese .

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrrojë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës,Gjykates se Larte per Kundervajtje, në afatin prej 8 ditësh,pas marrjes se ketij aktvendimi,nepermes kesaj gjykate dhe pa taksa

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

